



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 62

Prishtinë, më 21 nëntor 2012, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Haki Demolli, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Behar Selimi dhe Gëzim Kelmendi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Isuf Jahmurataj – MD; Lumnije Murati – ZPRK; Lejla Selimi – OSBE; Artan Canhasi – EULEX; Petrit Hysaj- OSBE; Rebeka Maliqi; Blerta Bejtullahu – Evo/EUSK; Etrur Maloku dhe Eliza Taana – US Embassy; Bekim Kodraliu- OSBE; Visar Smajlaj – ekspert dhe Shkëlzen Gërxhaliu – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 01 dhe 15.10.2012;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektkodin e procedurës penale;
4. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për procedurën përmbartimore;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-125 për shëndetësi;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve;

9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara;
10. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-111/k;
11. Njoftim i Komisionit me dosjen e dërguar nga A.B.;
12. Njoftim lidhur me dorëheqjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
13. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoi që pika e tretë dhe pika shtatë të hiqet nga rendi i ditës. Ai tha se këtë e ka kërkuar edhe kryesuesi i grupit të punës për projekt kodin e procedurës penale, i cili nuk ka mundur sot të jetë në këtë takim, si dhe për shkak se TAIEX-i ka sjellë disa propozime. Kurse ekspertet e angazhuar nga Komisioni e kanë përfunduar punën e tyre duke sjell ekspertizën sipas afateve të përcaktuar në Grup punues.

Armend Zemaj – Tha se në takimin e fundit që kemi pasur për këtë Projektkod, janë shqyrtuar propozimet e TAEX-it, ku është vlerësuar se këto propozime duhet t'i dërgohen edhe Ministrisë së Drejtësisë, pasi që ai prek edhe 3 fusha të ligjeve të tjera: Ligjin për Policinë e Kosovës, Ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe Kodin e Procedurës Penale, i cili është në shqyrtim e sipër. Prandaj, do të jetë e vështirë të inkorporohen ato propozime nga ai material i ekspertit të TAIEX-it. Nëse administrata është e gatshme, atëherë ne kemi marrë vendim, që ky material t'i kthehet Ministrisë së Drejtësisë, me kërkesën që të nisë procedura e ndryshim-plotësimit të 3 ligjeve të përmendura më lart. Prandaj, ai kërkoi që çështja të merret me seriozitet, në mënyrë që të mos neglizhohet procedura dhe të arrijmë me kohë ta miratojmë Kodin e Procedurës Penale.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, pra që pika e tretë dhe pika shtatë të hiqen nga rendi i ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 01 dhe 15.10.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 01 dhe 15.10.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve të grupit të në Projektligjin për procedurën përmbartimore

Haki Demolli – Në cilësi të kryesuesit të grupit të punës, e njoftoi Komisionin se grupi ka mbajtur 3 takime, në të cilat është shqyrtuar projektligji në përgjithësi dhe është vlerësuar si relativisht i mirë nga të gjithë ne. Si grup i punës, kemi propozuar 13 amendamente, kurse një amendament është propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu, me të cilin ka kërkuar që 323-397 të fshihen në tërësi. Ai u kërkoi deputetëve, që amendamenti i deputetes mos të votohet, sepse bie ndesh me amendamentet e Komisionit dhe si i tillë, e ndërron konceptin e ligjit.

Albulena Haxhiu – Tha se amendamenti të cilin e ka paraqitur është shumë përmbajtësor dhe atë e ka propozuar pas konsultimeve paraprake edhe me institucionet të cilat e kanë për detyrë ta zbatojnë atë ligj. Pra, nenet kanë të bëjnë me përmbartuesin privat, e që është risi në vendin tonë dhe në këtë fazë është i panevojshëm, pasi që do të ketë parregullsi, si në zgjedhjen, ashtu edhe në veprimtarinë e tyre. Gjithashtu, është gabim që ministri i Drejtësisë të caktojë përmbartuesin privat, pasi kjo mund të cilësohet edhe si ndërhyrje në sistemin gjyqësor. Kjo vlen edhe për caktimin e numrit të përmbartuesve privatë nga ana e Ministrisë dhe mund të vëreni se të gjitha vendimet kryesore për përmbartuesit

privatë i merr Ministria e Drejtësisë, përfshirë këtu edhe emërimet, caktimin e numrit të përmbaruesve, ndërhyrjet te CV-ja, organizimin e provimit, vulën e përmbaruesve privatë etj. Mendoj se është dashur që të rritet numri i përmbaruesve publikë në gjykata dhe të mbështeten në rastet kur ata kanë probleme me përbarimin e vendimeve gjyqësore, e jo të shtohet numri i përmbaruesve privatë, sepse edhe përvojat e vendeve të tjera kanë rezultuar joproduktive.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion në Projektligjin për procedurën përbarimore.*
- II. Komisioni nuk e përkrahu amendamentin e propozuar nga deputetja Albulena Haxhiu.*
- III. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit me amendamentet e propozuara nga Komisioni.*
- IV. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.*

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-143, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbrojtjen e bimëve dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për punimet nga metalet e çmuara dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-154 për punimet nga metalet e çmuara dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë, nr. 04-P-111/k

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e grupit të deputetëve, për të konstatuar bazueshmërinë e rekomandimit për formimin e një komisioni të ekspertëve ndërkombëtarë, për t'i shqyrtuar CV-të e anëtarëve të ASHAK-së.

Komisioni, duke u bazuar në Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, vlerësoi se rekomandimi për formimin e një komisioni të ekspertëve ndërkombëtarë, për t'i shqyrtuar CV-të e anëtarëve të ASHAK-së, nuk ka bazë juridike dhe është në kundërshtim me e Ligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me të cilin është përcaktuar organi, i cili bën zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Lidhur me këtë, kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri nxori

Përfundim

Komisioni vlerësoi se kërkesa e grupit të deputetëve për ta konstatuar bazueshmërinë e rekomandimit për formimin e një komisioni të ekspertëve ndërkombëtarë, për t'i shqyrtuar CV-të e anëtarëve të ASHAK-së, nuk ka bazë juridike për procedim të mëtutjeshëm.

9. Njoftim i Komisionit me dosjen e dërguar nga A.B.

Komisioni u njoftua me dosjen e dërguar nga Arben Bashota, e cila nuk përmbante ndonjë shkresë përcjellëse përmes së cilës Komisioni do të mund ta kuptonte qëllimin e dërgesës.

10 njoftim lidhur me dorëheqjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni u njoftua me dorëheqjen e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Bilgaip Maznikar, i cili është emëruar noter, me zyrë në Prizren.

11. Të ndryshme

a. U formua grupi i punës për Projektligjin për avokaturën shtetërore, në këtë përbërje:

Haki Demolli (kryesues),
Albulena Haxhiu (anëtare),
Armend Zemaj (anëtar),
Halit Krasniqi (anëtar),
Jasmina Zhivković (anëtare).

Ekspert për ofrimin e mbështetjes së grupit të punës, u caktua Visar Smajlaj.

b. Diskutim lidhur me Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale

Albulena Haxhiu – Kishte vërejtje në grupin e punës, lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale. Vërejtjet u shfaqen edhe në përmbajtjen e projektligjit, por edhe në punën e kryesuesit, i cili sipas saj, nuk është treguar

serioz në punën e tij. Ju e dini që në seancën plenare, opozita ka votuar kundër këtij ligji, por e dini që edhe në dëgjimin publik, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme, ku ka qenë pjesëmarrëse edhe Ministria e Drejtësisë dhe gjatë këtij dëgjimi publik kanë dalë disa konkluzione të tilla, si: çështja e emërimit, barra e provës dhe çështja e retroaktivitetit. Grupin e punës është vendosur që ta udhëheqë Behar Selimi, i cili me keqardhje them se nuk po i trajton çështjet me seriozitetin më të madh. Në takimin e fundit të grupit të punës, Behar Selimi kishte thënë se Komisioni nuk ka të drejtë të bëjë ndryshime përmbajtësore, por vetëm të karakterit teknik, prandaj konsideroj që me fjalë të tilla, po zhvleftësohet edhe puna e Komisionit për Legjislacion. Në fund, ajo propozoi që të ndërrohet kryesuesi i grupit të punës.

Kryetari – Kryesuesi i Komisionit është përcaktuar në Komision dhe, po ashtu, ata janë grupi më i madh politik, prandaj nëse ata janë të përcaktuar ta kalojnë atë, atëherë edhe do ta bëjnë. Projektligji ka mangësi edhe në përmbajtje dhe atë nuk e përmirëson çfarëdo titulli që mund t'i vëmë, dhe as me amendamente të propozuara.

Halit Krasniqi – Ai shprehu reagimin e tij lidhur me diskutimet që bëheshin për kryesuesin e grupit të punës, për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale, në mungesë të tij. Ai kërkoi që të respektohet niveli i moshës, detyrës dhe formësimi profesional i deputetëve.

Armend Zemaj – Duke u ndërlidhur me parafolësit, tha se fillimisht duhet të shikohet se a i përmbush ky projektligj pritjet tona, për të cilin ne si subjekt politik kemi vlerësuar se nuk e bën një gjë të tillë, pasi që nuk e rregullon fushën e luftimit të krimit dhe korrupsionit. Duke folur për kryesuesin e grupit të punës, tha se arsyeja që kryesuesi është përmbajtur nga ndërhyrja në titull është se nëse ndërrohet titulli do të duhej të ndërhyhet edhe në përmbajtjen strukturore. Ne jemi munduar që të bëjmë ndërhyrje përmes amendamenteve, mirëpo shihet qartë se nga titulli e deri në fund, ligji nuk i përmbush pritjet tona në luftën kundër korrupsionit, i cili mbetet pjesë e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, me disa kompetenca të zgjeruara në pjesë të caktuara. Në fund, ai shtoi se ka mungesë të vullnetit politik të brendshëm dhe të jashtëm në luftën kundër korrupsionit.

Ardian Gjini – Tha se kryesuesi i këtij grupi mund të jetë shumë i përgjegjshëm, mirëpo shihet qartë se Partia Demokratike e Kosovës nuk ka dashur ta bëjë këtë projektligj, ashtu siç kemi dashur ne, por tani për tani ata i kanë votat për ta proceduar çështjen përpara, prandaj e tëra që mund të bëhet është të përcillen procedurat e votimit për ose kundër, apo në raste të caktuara, të bojkotohet mbledhja apo seanca, dhe kjo është mënyra e vetme për zgjidhjen e çështjeve, pasi që ne jemi thjesht politikanë. Në fund, ai shtoi se grupi i tij politik është kundër këtij projektligji.

Kryetari – Shtoi se grupi duhet të ndërtojë konsensus brenda Komisionit, pasi në fund të fundit ata janë grup politik, por që gjithsesi kemi edhe instrumentet demokratike për të kundërshtuar, e të cilat janë vota dhe bojkoti. Si grupe politike dhe si opozitë, ne mund ta bojkotojmë Komisionin dhe partitë në pushtet le ta vazhdojnë punën pa ne. Nëse grupi i punës nuk arrin të marrë vendim, atëherë le të mbetet që të diskutohet në mbledhjen e radhës, kur është edhe kryesuesi prezent dhe marrim vendim si Komision, nëse duam ta shtyjme këtë çështje përpara apo jo.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi

Amendamenti 1

Neni 46, paragrafi 1.1.4 riformulohet si vijon: “ **Xhirollogaritë e tjera të parave të gatshme, ose ato të cilat nuk kanë të bëjnë me para të gatshme të debitorit përmbarues.** “

Amendamenti 2

Neni 46, paragrafi 1.1.8 , fjala “ të pranueshmet “ hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “ të hyrat” dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 3

Neni 71, paragrafi 1.1, fjala “ **është**” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “ **ka** “ dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 4

Neni 73, paragrafi 3, pas fjalës “**prapësimi**” shtohet fjala “ **mund të** : “dhe teksti vazhdon si në Projektligj.

Amendamenti 5

Neni 104, paragrafi 2 riformulohet si vijon: “ **Blerësi nuk ka të drejtë ankese për të metat fizike dhe juridike të sendit**” .

Amendamenti 6

Propozim i deputetes Albulena Haxhiut pa përkrahjen e Komisionit

Nenet nga 323 deri në nenin 398 të fshihen në tërësi.

Amendamenti 7

Neni 367.2, hiqet.

Amendamenti 8

Neni 368,2

Në rreshtin e parë fjalët “**do të** “ hiqen dhe zëvendësohen me fjalët “ **mund ta**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9

Neni 369, paragrafët 2,3,4 dhe 7 bëhen neni 370 me titull “ Përbërja e komisionit disiplinor”. Kurse paragrafët 5 e 6 të këtij neni hiqen.

Ndërkaq neni 370 i projektligjit hiqet dhe nenet në vazhdim radhiten sipas numrave me radhë.

Amendamenti 10

Neni 372 hiqet.

Amendamenti 11

Neni 374, shtohen paragrafët 10 e 11 me përmbajtën si vijon;

374. 10. Pas zbatimit të procedurës disiplinore Komisioni disiplinor nxjerr vendim.

374.11. Procedura disiplinore me hollësisht do të rregullohet me akt nënligjor të Ministrisë.

Amendamenti 12

Neni 375

Titulli riformulohet si vijon:

“ Vendimi i komisionit disiplinor”.

Paragrafi 4 riformulohet si vijon:

Pa vonesë komisioni disiplinor i përcjell vendimin me shkrim ministrit, përmbauesit privat dhe Odes. Vendimi shpallet publikisht në faqen zyrtare të Ministrisë dhe të Odes.

Shtohet paragrafi 5 me përmbajtje si vijon:

Vendimi i komisionit disiplinor është përfundimtar. Kundër vendimit të komisionit disiplinor mund të ngritët konflikti administrativ.

Amendamenti 13

Neni 376,

Hiqet dhe nenet në vazhdim radhiten sipas numrave me radhë.